



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.05.2023

Nr: 130

Ora: 13:50

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 70, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA ALEANCA PROGRESISTE LZHK"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** "Partia Aleanca Progresiste LZHK", përfaqësuar nga z. Fabian Topollari

**OBJEKT:**

- Kundërshtim i vendimit nr. 260, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 07, Pukë "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Pukë"
- Rinumërim dhe rivlerësim i votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshillin për QV 0408, 0415, 0415/1, 0422, 0424, 0425 dhe 0430.



3. Ndryshimin e tabelës për rezultatin për keshillin bashkiak Pukë duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Partia “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 70 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 23.05.2023, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 70 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 70, datë 22.05.2023, të paraqitur nga “Partia Aleanca Progresiste LZHK”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 24.05.2023, ora 15:00.

3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>